

Vendim nr. 146 datë 26.06.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Elsa Toska, anëtarë, në datën 26.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:	TOM DEDAJ
OBJEKTI:	Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-375, datë 05.03.2024 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
BAZA LIGJORE:	Nenet 4, 42, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (<i>Kushtetuta</i>); nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (<i>KEDNJ</i>); nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (<i>ligji nr. 8577/2000</i>).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nga data 01.12.2013 deri në datën 01.11.2016, kur është pezulluar me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak të nisjes ndaj tij të procedimit penal për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”,

të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve prokuroria e ka përcjellë çështjen për gjyq.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 88, datë 26.07.2018, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit për veprën penale sipas akuzës dhe e ka dënuar atë me tre (3) vjet burgim, duke i hequr të drejtën për të ushtruar funksione publike për pesë (5) vjet, si dënim plotësues, dhe në aplikim të nenit 59 të KP-së ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë 5-vjeçare, duke e vendosur atë në periudhë prove.

3. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 89, datë 06.11.2018, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur deklarinim fajtor të tij për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së dhe dënimin me një (1) vit burgim. Po kështu, gjykata e apelit i ka dhënë edhe dënim plotësues, duke e ndaluar të ushtrojë funksione publike për një (1) vit. Dënimi me burgim është pezulluar dhe kërkuesi është vënë në periudhë prove për dy (2) vjet. Sipas kërkuesit, dënimi është shuar për shkak të zbatimit të ligjit për amnistinë të vitit 2020.

4. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs palët ndërgjyqëse, kërkuesi dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 57210-00111-00-2019 akti, datë 25.01.2019.

5. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, kërkuesi në datën 30.01.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shkak të vonesave në gjykimin e rekursit, bazuar në nenet 399/1, 399/2, 399/5 – 399/7 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, ka kërkuar mendim nga gjyqtari relator i çështjes, i cili ka parashtruar se çështja është në fazën e studimit. Sipas tij, duke pasur parasysh datën e regjistrimit të çështjes dhe numrin e çështjeve që presin për t’u gjykuar pranë Kolegjit Penal, me regjistrim më të hershëm në kohë, gjykimi i çështjes ka qenë i pamundur për rrethana objektive. Ai ka bërë me dije se çështja e themelit është planifikuar për t’u shqyrtuar në datën 19.03.2024.

7. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-375, datë 05.03.2024, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me arsyetimin se çështja e themelit do të merret në shqyrtim në datën 19.03.2024 dhe për pasojë çështja për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm, për shkak të vonesave në gjykimin e rekursit, ka mbetur pa objekt.

8. Ndërkohë nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se: (i) në datën 09.02.2024 Kolegji Penal i asaj gjykate ka planifikuar për gjykim çështjen e kërkuesit në datën 19.03.2024; (ii) shqyrtimi i çështjes i planifikuar për datën 19.03.2024 është shtyrë për datën

16.04.2024, për shkak të paraqitjes së kërkesës për heqje dorë të gjyqtarit Sokol Binaj; (iii) shqyrtimi i çështjes i planifikuar në datën 16.04.2024 është shtyrë për në datën 18.04.2024 (në faqen e Gjykatës së Lartë nuk rezultoi e pasqyruar ndonjë e dhënë për shkakun e shtyrjes); (iv) në datën 18.04.2024 Kolegji Penal ka shqyrtuar rekursin dhe ka vendosur mospranimin e tij.

9. Në datën 28.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në konkluzionet e parashtrimeve të tij në kërkesë, kërkuesi ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Lartë, konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga ajo gjykatë, urdhërimin për përfundimin e gjykimit të çështjes dhe dëmshpërblimin për vonesën e shkaktuar në masën 300 000 000 lekë. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se i është cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi është dërguar në Gjykatën e Lartë në datën 19.01.2019 dhe deri në datën 30.01.2024, kur ai ka paraqitur kërkesën për shkelje të afatit kanë kaluar mbi pesë vjet. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar përcaktimet e nenit 399/3, pika 3, të KPC-së, pasi e ka shqyrtuar kërkesën e tij pas 35 ditësh, pra përtej afatit ligjor 30-ditor.

10.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje sanksionit që ka përcaktuar legjislacioni lidhur me shpërblimin e dëmit, i cili është një dëm real dhe efektiv.

10.2. *Parimi i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë shkelur haptazi ligjet, kodet, Kushtetutën dhe legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut, duke dhënë vendime kundër interesave të tij. Sipas kërkuetit, sjellja diskriminuese mund të vijë për shkak të përkatësisë fetare, politike e krahinore ose për shkak të detyrës që ai ka kryer, pasi kolegë të tij për situata të njëjta janë dëmshpërblyer, ndërsa ai ka tetë (8) vjet që endet në prokurori dhe gjykata.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

13. Duke verifikuar plotësimin e këtyre kriterëve, në rastin konkret Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Po kështu, ai ka *shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion*, pasi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka pushuar gjykimin e kërkesës së tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e rekursit të regjistruar për gjykim në vitin 2019, ndaj i vetmi mjet në dispozicion është ankimi kushtetues individual. Gjithashtu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 05.03.2024, ndërsa kërkesa është dërguar me shërbim postar në datën 28.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të parimit të mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës.

15. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat kanë shkelur ligjin dhe i kanë krijuar pengesa në dhënien e të drejtave që i takonin, dhe se kjo mënyrë sjelljeje vjen, sipas tij, për shkak të përkatësisë fetare, politike, krahinore ose profesionale. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se argumentet e kërkuesit janë me natyrë të përgjithshme, ndërsa nuk ka provuar se si shkaqet e vlerësuar prej tij si diskriminuese kanë ndikuar në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ajo ka pushuar gjykimin e shqyrtimit të kërkesës për shkak se çështja e themelit tashmë ishte planifikuar për shqyrtim nga kolegji përkatës. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin

e parimit të mosdiskriminimit nuk është ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, kërkuesi ka argumentuar, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar përcaktimet e nenit 399/3, pika 3, të KPC-së, pasi e ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm pas 35 ditësh, pra përtej afatit ligjor 30-ditor. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, pretendimi kryesor i kërkuesit lidhet me kohëzgjatjen e gjykimit të themelit nga Gjykata e Lartë dhe vendimi gjyqësor që shqyrton kërkesën për përshpejtimin e procedurave është në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese dhe nuk mund të qëndrojë në mënyrë autonome nga pretendimi kryesor (*shih vendimin nr. 64, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, këto argumente të kërkuesit do të analizohen në këndvështrim të pretendimit kryesor që lidhet cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të rekursit në Gjykatën e Lartë.

17. Kërkuesi ka pretenduar se rekursi është dërguar në Gjykatën e Lartë në datën 19.01.2019 dhe deri në datën 30.01.2024, kur ai ka paraqitur kërkesën për shkelje të afatit, kanë kaluar mbi pesë (5) vjet. Sipas kërkuesit, pushimi i gjykimit nga Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje për shpërblimin e dëmit, i cili është një dëm real dhe efektiv dhe që i takon sipas ligjit.

18. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ndaj kërkuesit është zhvilluar një proces penal, gjatë të cilit gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 26.07.2018, e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së dhe dënimin takues me burgim e ka pezulluar duke e vendosur në periudhë prove për pesë (5) vjet. Cilësimi i veprës penale dhe masa e dënimit janë zbutur nga gjykata e apelit, e cila, me vendimin e datës 06.11.2018, e ka dënuar kërkuesin për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i KP-së dhe e ka vendosur atë në periudhë prove për dy (2) vjet. Sipas kërkuesit, dënimi është shuar për shkak të zbatimit të ligjit për amnistinë të vitit 2020. Rekursi i palëve, përfshirë edhe ai i kërkuesit, është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 25.01.2019.

20. Pas më shumë se 5 vjetëve, në datën 30.01.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm, bazuar, ndër të tjera, në nenet

399/1, 399/2, 399/5, 399/6 dhe 399/7 të KPC-së. Në përfundim, Gjykata e Lartë në datën 05.03.2024 ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës, për shkak se çështja e themelit (rekursi) ishte planifikuar për gjykim (19.03.2024), ndaj çështja në fjalë kishte mbetur pa objekt. Rreth 1 muaj e gjysmë më vonë (18.04.2024), Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim për mospranimin e rekursit të palëve. Kërkuesi pas dhjetë (10) ditësh që Gjykata e Lartë kishte vendosur për themelin e çështjes (28.04.2024) i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit të asaj gjykate që ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të rekursit.

21. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve penale, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit për krime në Gjykatën e Lartë (*neni 399/2, pika 1, shkronja "d", i KPC-së*). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

22. Gjykata ka konstatuar se vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Po kështu, ajo ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 61, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në praktikën e saj Gjykata çështjet me objekt tejkalgjatjen e paarsyeshme të afatit i ka analizuar mbështetur në rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, në kushtet kur shqyrtimi i kërkesës për tejkalgjatjen e afatit të arsyeshëm është pushuar për shkak të planifikimit të gjykimit të rekursit dhe ndërkohë që procesi i themelit është përmbyllur me vendim përfundimtar të Gjykatës së Lartë (18.04.2024), Mbledhja e Gjyqtarëve do të analizojë rastin në fjalë të lidhur vetëm me *rëndësinë e asaj çfarë ka rrezikuar* kërkuesi.

24. Në drejtim të këtij kriteri, Gjykata ka pranuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për kërkuesin

e drejta objekt gjykimi. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuarit në proces verifikohet rast pas rasti (*shih vendimin nr. 25, datë 11.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se procesi penal në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i kërkuarit dhe i prokurorisë ndaj vendimit të gjykatës së apelit, e cila ka lehtësuar në masë të konsiderueshme pozitat e kërkuarit si në drejtim të cilësimit të veprës penale, ashtu edhe në atë të masës së dënimit (dy vjet në periudhë prove). Në përfundim të shqyrtimit të rekurseve, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe ligjore, ndaj vendimi i dhënë nga gjykata e apelit, i cili ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, ka mbetur i pandryshuar. Në kontekst të këtyre rrethanave, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit nuk duket t'i ketë sjellë kërkuarit ndonjë pasojë ose dëm të interesave të tij. Për më tepër, mospranimi i rekursit ka lënë të pandryshuar gjendjen e tij sipas lehtësive të disponuara nga gjykata e apelit, që do të thotë se, në thelb, atij nuk i është rrezikuar ndonjë interes vetjak. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve mban në konsideratë se edhe vetë kërkuari nuk ka treguar diligjencën e duhur ndaj interesave të tij, në kushtet kur ai ka paraqitur kërkesën për konstatim të tejzgjatjes së afatit pesë (5) vjet pasi rekursi ishte regjistruar për gjykim (25.01.2019) ose rreth katër (4) vjet pas rifillimit të funksionimit të Gjykatës së Lartë (11.03.2020).

26. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se kërkesa për konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të rekursit, në rastin e kërkuarit nuk duket të ketë qenë mjet joefektiv, pasi çështja në themel në Gjykatën e Lartë ka përfunduar (18.04.2024) brenda tre (3) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe përpara se ai t'i drejtohej Gjykatës me ankim kushtetues individual (28.04.2024). Parë nën dritën e kësaj analize, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkuesit Tom Dedaj, me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka pushuar gjykimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, bashkohemi me përfundimin se çështja nuk duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare, por me arsyetim të ndryshëm.

2. Në rastin konkret, ka rezultuar se kërkuesi është deklaruar fajtor dhe është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin e datës 26.07.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin e datës 06.11.2018 dhe kërkuesi është deklaruar fajtor dhe është dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i KP-së. Sipas kërkuesit, dënimi i është amnistuar me ligjin e vitit 2020. Në datën 25.01.2019 në Gjykatën e Lartë është regjistruar rekursi i ushtruar nga kërkuesi dhe prokuroria. Pas më shumë se pesë (5) vjetësh, në datën 30.01.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e rekursit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Në datën 09.02.2024, pra pas 10 ditësh nga paraqitja e kërkesës, Gjykata e Lartë ka nxjerrë njoftimin për shqyrtimin e rekursit në datën 19.03.2024. Për këtë shkak, në datën 05.03.2024, Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, me argumentin se në kushtet kur çështja e themelit do të merret në shqyrtim, kjo kërkesë ka mbetur pa objekt (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në vijim, rekursi i kërkuesit është shqyrtuar përfundimisht në datën 18.04.2024 dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve ligjore. Ndonëse Gjykata e Lartë është shprehur me vendim përfundimtar në datën 18.04.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 28.04.2024, pra 10 ditë më vonë, duke pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga ajo gjykatë për shkak të kohëzgjatjes së shqyrtimit të rekursit përtej afateve ligjore.

3. Në përfundim të shqyrtimit paraprak, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit nuk duket t'i ketë sjellë kërkuesit ndonjë pasojë ose dëm të interesave të tij. Sipas saj, procesi penal në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje edhe nga rekursi i kërkuesit dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur mospranimin me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe ligjore. Në këtë mënyrë ka mbetur i pandryshuar vendimi i gjykatës së apelit, i cili ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm e që ka lehtësuar në masë të konsiderueshme pozitat e kërkuesit si në drejtim të cilësimit të veprës

penale, ashtu edhe në drejtim të masës së dënimit. Në këto rrethana, kërkuesit, në thelb, nuk i është rrezikuar ndonjë interes vetjak. Ai nuk ka treguar dilijencën e duhur ndaj interesave të tij, në kushtet kur e ka paraqitur kërkesën pesë (5) vjet pasi rekursi ishte regjistruar për gjykim ose katër (4) vjet pas rifillimit të funksionimit të asaj gjykate. Për më tepër, shprehet Mbledhja e Gjyqtarëve, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin brenda tre (3) muajve nga paraqitja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, ndaj mjeti i përdorur nuk duket të ketë qenë joefektiv në rastin e tij (*shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit*).

4. Në ndryshim për sa është argumentuar më sipër, vlerësojmë se nga paraqitja e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit (30.01.2024), Gjykata e Lartë jo vetëm ka vepruar në kohë shumë të shpejtë, pothuajse brenda 10 ditëve, në planifikimin e shqyrtimit të rekursit të kërkuesit (09.02.2024), por edhe vetë shqyrtimi rekursit është përmbyllur brenda tre (3) muajve. Për më tepër, në përfundim të gjykimit të rekursit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, që do të thotë se, në thelb, shkaqet e rekursit ishin të papranueshme në raport me ligjin, faktet dhe rrethanat e çështjes së themelit. E thënë ndryshe, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi ka dëshmuar se ka qenë efektive në përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të tij, të cilin Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar, pasi, sipas saj, kërkuesit nuk i ishte cenuar ndonjë liri ose e drejtë kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, gjë e cila do të mund të bënte të cenueshme vendimmarrjet e tyre.

5. Për sa i takon këtij vlerësimi mbajmë në konsideratë se nenet 399/1 e vijues të KPC-së kanë përcaktuar mjetet të cilat synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese të individit për zhvillimin e procedurave/gjykimit brenda një afati të arsyeshëm duke siguruar: i) parandalimin e shkeljes, në kuptimin që në një çështje konkrete, e cila është duke u zgjatur në kohë, të urdhërohet përshpejtimi i procedurave në mënyrë që individit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; ii) riparimin e shkeljes nëpërmjet përfundimit të procedurave sa më shpejt të jetë e mundur dhe, eventualisht, caktimit të një dëmshpërblimi. Pra, KPC-ja ka njohur dy instrumente në këtë drejtim, që janë kërkesa për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procesit dhe, më pas, kërkimi i dëmshpërblimit që është kompetencë e gjykatës së shkallës së parë. Këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në mënyrë subsidiare, pra në atë mënyrë që, në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive për shmangien e shkeljes përmes përshpejtimin të procedurave, atëherë ato i lënë vend aplikimit të mjeteve riparuese kompensuese të kësaj vonese.

6. Në lidhje me efektivitetin e këtyre mjeteve juridike, Gjykata ka theksuar se, si rregull, për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes ose zvarritjes së procedurave, mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjyqësorit të zakonshëm, ndërkohë që Gjykata investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se ato nuk janë në gjendje të korrigjojnë dhe riparojnë shkeljen e së drejtës

për proces të rregullt, pra në rast se provohet se mjete juridik nuk ka qenë efektiv (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjithashtu, Gjykata ka evidentuar se mjetet e reja juridike që parashikon legjislacioni në dispozicion të individit janë testuar në lidhje me efektivitetin e tyre në një situatë jo të zakonshme të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore. Për këtë arsye, është e nevojshme që edhe vetë individi të tregojë kujdesin e duhur, në kohën e duhur. Kjo do të thotë se individi, përpara se të kërkojë shpërblimin e dëmit, duhet të përdorë në kohën e duhur mjetin juridik parandalues/përshpejtues (kupto kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave). Një qasje e tillë përputhet me qëllimin e mjeteve juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, si dhe me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e zakonshme nuk kanë qenë në gjendje të riparojnë shkeljen e së drejtës për proces të rregullt (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në çështjen në fjalë, rezulton se mjete i përdorur nga kërkuesi (kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm) ka rezultuar efektiv, pasi çështja e tij u planifikua për shqyrtim brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij, duke bërë që procedurat e gjyqësorit të rekursit të përshpejtohen me qëllim që kërkuesit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Rrjedhimisht, efektiviteti i këtij mjeti, për shkak të natyrës subsidiare, nuk i lë vend aplikimit të mjetit tjetër atij riparues kompensues. Kjo nënkupton se kërkuesi nuk mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të procesit.

9. Nën dritën e kësaj analize, çmohet se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi Tom Dedaj nuk plotëson kriteret për kalim në seancë plenare, pasi kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e rekursit ka rezultuar efektive dhe rekursi i tij është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka disponuar mospranimin e tij për shkaqe ligjore.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak që i përket çështjes me kërkues Tom Dedaj, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-375, datë 05.03.2024 të Gjykatës së Lartë, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, sepse në vlerësimin tim ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi plotësonte të gjitha kriteret paraprake të pranueshmërisë, përfshirë edhe kriterin *ratione materiae* për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj çështja duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare.

2. Nga rrethanat e rastit konkret rezulton se çështja e kërkuesit ka nisur në datën 01.11.2016, kur ndaj tij, fillimisht, Prokurori i Përgjithshëm ka disponuar urdhrin për pezullimin nga detyra. Më pas ka vijuar procesi gjyqësor gjatë të cilit gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 26.07.2018, e ka deklaruar kërkuesin fajtor sipas akuzës. Po kështu, edhe gjykata e apelit, me vendimin e datës 06.11.2018, ka lënë në fuqi fajësinë e kërkuesit, por për një vepër tjetër penale, duke i dhënë edhe dënimin përkatës. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me deklarin e fajësisë ka ushtruar rekurs që është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 25.01.2019. Pasi ka qenë në pritje të shqyrtimit të rekursit për më shumë se pesë (5) vjet, në datën 30.01.2024 ai i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në shqyrtimin e rekursit, duke përdorur në këtë mënyrë mjetet e reja procedurale ligjore për këtë qëllim të parashikuara në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Rreth dhjetë (10) ditë më pas, në datën 09.02.2024, Gjykata e Lartë ka planifikuar shqyrtimin e rekursit në datën 19.03.2024. Në këtë situatë, kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë në datën 05.03.2024 ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me argumentin se çështja ka mbetur pa objekt. Në vijim, rekursi i kërkuesit është shqyrtuar përfundimisht në datën 18.04.2024 nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e tij. Duke pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të kohëzgjatjes së shqyrtimit të rekursit përtej afateve ligjore, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës 05.03.2024.

3. Shumica, pasi ka analizuar pretendimin e kërkuesit në këndvështrim të *rëndësisë së asaj se çfarë ka rrezikuar*, ka vlerësuar se ai nuk mund të merret në shqyrtim, sepse kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit nuk duket t'i ketë sjellë kërkuesit ndonjë pasojë ose dëm të interesave të tij. Sipas saj, procesi penal në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje edhe nga rekursi i kërkuesit dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur mospranimin me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe ligjore. Në këtë mënyrë ka mbetur i pandryshuar vendimi i gjykatës së apelit, i cili ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm dhe që ka lehtësuar në masë të konsiderueshme pozitat e kërkuesit

si në drejtim të cilësimit të veprës penale, ashtu edhe në drejtim të masës së dënimit. Në këto rrethana, sipas shumicës, kërkuetit, në thelb, nuk i është rrezikuar ndonjë interes vetjak. Ai nuk ka treguar diligjencën e duhur ndaj interesave të tij, në kushtet kur e ka paraqitur kërkesën pesë (5) vite pasi rekursi ishte regjistruar për gjykim ose katër (4) vite pas rifillimit të funksionimit të asaj gjykate. Për më tepër, shprehet shumica, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin brenda tre (3) muajve nga paraqitja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, ndaj mjeti i përdorur nuk duket të ketë qenë joefektiv në rastin e tij (*shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit*).

4. Përkundër vlerësimit të shumicës çmoj se përmbushet kriteri i rëndësisë së asaj se çfarë i është rrezikuar kërkuetit nga kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit, pasi ai ka qenë nën një akuzë penale, në cilësinë e të akuzuarit, dhe ka mbartur përgjatë pesë (5) vjetëve që ishte në pritje të shqyrtimit të rekursit pasojat e dënimit për veprime të paligjshme ndaj të cilave ka pretenduar pafajësi, pra interesat e tij dukshëm janë drejtpërdrejt të rrezikuar. Lidhur me këtë, vlerësoj se qëllimi i kërkuetit në paraqitjen e një kërkesë të tillë, përveç përsheptimit të gjykimit dhe lirit nga akuzat për të cilat është dënuar nga gjykatat e faktit, lidhet edhe me përfitimin e dëmshpërblimit për shkak të vonesave në gjykim, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së.

5. Në analizë të nenit 399/1 të KPC-së, që parashikon se në kompetencë të gjykatave hyn edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, theksoj se qëllimi i ligjvënësit është që, në çdo rast që konstatohet se ka një kohëzgjatje të paarsyeshme, të ketë dëmshpërblim të drejtë (si në secilën nga fazat e gjykimit, ashtu edhe në drejtim të të gjithë procesit në tërësi). Kjo është arsyeja që vetë dispozita në fjalë parashikon që gjykatat përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, si dhe shpërblimin e drejtë, që nga procedurat e hetimit, të gjykimit të çështjeve dhe deri në ekzekutimin e vendimeve. Në rastin konkret, objekti i kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejkalimit të çdo afati të arsyeshëm përfshin: (i) konstatimin e faktit të kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe (ii) kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga kjo tejzgjatje e paarsyeshme.

6. Në të njëjtën linjë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka konfirmuar se neni 13 i KEDNJ-së është një mjet efektiv nëse ai mund të përdoret ose për të përsheptuar dhënien e vendimit nga gjykata që shqyrton çështjen, ose për t'i siguruar palës korrigjimin për vonesat që kanë ndodhur tashmë (*shih Sürmeli kundër Gjermanisë [DhM], 2006, § 99*). Po sipas saj, ndërsa mjeti parandalues është i preferueshëm, një mjet kompensues mund të konsiderohet si efektiv kur procedurat tashmë kanë qenë tepër të gjata dhe nuk ka asnjë mjet parandalues të disponueshëm (*shih Kudla kundër Polonisë [DhM], 2000, § 158; Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM]*). Për sa i përket përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së një kompensimi të tillë, ky përfundim zbatohet vetëm me kushtin që një kërkesë për kompensim të mbetet në vetvete një mjet

juridik efektiv, i përshtatshëm dhe i aksesueshëm në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore (*shih Mifsud kundër Francës [DhM], 2002, § 17*). Në lidhje me mjetin e parashikuar nga legjislacioni shqiptar, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se zgjidhja për përsheptimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, § 119*).

7. Mbështetur në standardet e sipërcituara vë në dukje se kërkuesi në kohën që ka paraqitur kërkesën në Gjykatën e Lartë ka pasur pritshmëri në drejtim të asaj faze konkrete në të cilën ndodhej procesi gjyqësor, duke synuar jo vetëm përsheptimin e procedurave, për sa kohë që objekt i rekursit ishte një vendim i gjykatës së apelit që e kishte deklaruar atë fajtor dhe dënimi ndaj tij ishte bërë i ekzekutueshëm, por edhe për të përfituar dëmshpërblimin përkatës për këtë gjë. Për më tepër, kërkuesi ka ngritur pretendime si në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë për shqyrtimin e rekursit, ashtu edhe në lidhje me procesin penal dhe kohëzgjatjen tërësore të procedurave, të cilat kanë filluar që në vitin 2016.

8. Në analizë të këtyre fakteve, theksoj se kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga kohëzgjatja nuk është automatikisht i lidhur vetëm me parandalimin e vonesës ose përsheptimin e gjykimit. Në këtë kontekst i qëndroj mendimin tim të shprehur në mendimet e pakicës në çështjet me nr. 8 (L) 2023 të Regjistrisë Themeltar me kërkuese Ledina Mandija dhe me nr. 13 (A) 2022 të Regjistrisë Themeltar me kërkues Agron Bajri, ku kam parashtruar se mjetet e mësipërme juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në atë mënyrë, që në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive, ato i lënë vend aplikimit të mjeteve korrigjuese të kësaj vonese.

9. Për sa më lart, vlerësoj se ligjvënësi shqiptar në marzhin e tij të vlerësimit ka përzgjedhur që mjeti ligjor i parashikuar për tejzgjatjen e paarsyeshme të proceseve gjyqësore ka dhe duhet të ketë një efektivitet me natyrë të dyfishtë. Në analizën e natyrës së mjeteve të parashikuara nga ligjvënësi, kompensimi për dëmshpërblimin e drejtë është një mjet efektiv, i cili mund të përdoret: (i) si në mënyrë kumulative i shoqëruar me funksionin e përsheptimit ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme; (ii) ashtu edhe si mjet i mëvetshëm kur kërkuesi e ka humbur interesin për përdorimin e përsheptimit/parandalimit si mjet, por synon vetëm konstatimin e vonesës, për shkak se tejzgjatja është aq e tejkualuar në kohë, sa parandalimi nuk ka më asnjë vlerë përdorimi. Fakti që Gjykata e Lartë ka shpallur një datë për gjykimin e çështjes së themelit në dhomën e këshillimit në datën 09.02.2024, ndërkohë që kërkuesi ka bërë kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt nga Gjykata e Lartë në datën 30.01.2024 (pra, pas 10 ditësh), ka bërë që Gjykata e Lartë në datën 05.03.2024, të vendosë pushimin e gjykimit, sepse ka vlerësuar se çështja ka mbetur pa objekt. Në vlerësimin tim, analizimi i fakteve të tilla në referencë

tepër të ngushtë të datave dhe ditëve, duke harruar që bëhet fjalë për një proces me natyrë penale, ku kërkuesi ka qenë në pozitat e të akuzuarit, çka bën që kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret duket të ketë rëndësi të madhe në drejtim të asaj që ai rrezikon si i akuzuar në procesin gjyqësor penal, duket se e bën mjetin e konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe kompensimin e drejtë, joefektiv. Nëse do të vijohet me këtë logjikë, në konkluzion i bie që dispozita (*neni 399/1 i KPC-së*) të mos përdoret pothuajse fare, duke e bërë tejzgjatjen e paarsyeshme *quasi* të pakompensueshme në asnjë rast.

10. Nga ana tjetër, jo rrallëherë është konstatuar qasja e Gjykatës së Lartë në drejtim të shqyrtimit të këtyre kërkesave, për sa kohë ajo gjykatë ndalet në vlerësimin e të tilla kërkesave vetëm duke referuar faktin e planifikimit të datës së shqyrtimit të rekursit, por pa analizuar asnjë nga elementet që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin dhe kompetencën si gjykatë e ligjit të interpretojë dispozitat e reja procedurale në drejtim të pasojave të tyre mbi të drejtat e individit, ajo nuk e ka bërë një gjë të tillë në rastin konkret, duke i shndërruar këto mjete joefektive në praktikë, për sa kohë që ato nuk arrijnë të garantojnë shpërblimin e drejtë.

11. Në përfundim, për sa më sipër, vlerësoj se kërkesa nuk dukej të ishte haptazi e pabazuar, ndaj duhej të ishte vendosur kalimi i saj për shqyrtim në seancë plenare me qëllim vlerësimin në themel të pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe në eventualitetin e pranimit të saj, të mund të vlerësohej edhe e drejta për kompensimin e shpërblimit të drejtë për kërkuesin Tom Dedaj.

Anëtare: Marjana Semini